Madlina Puka

Lektore në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve, Znj. Puka diskuton se si industria e turizmit po riorganizohet në Ballkanin Perëndimor për tu rikuperuar në përgjigje të krizës pandemike COVID-19.
Në veçanti, ajo flet për qasjen strategjike të rikuperimit të turizmit të shumë-destinacioneve për Ballkanin Perëndimor si një funksionim elastik i industrisë së turizmit.

"Për shkak të krizës pandemike COVID-19 dhe kufizimeve globale të udhëtimeve, Ballkani Perëndimor pati një ulje prej 98% të numrit të vizitorëve ndërkombëtarë në gjysmën e dytë të vitit 2020. Sa premtues është sezoni aktual i verës?

Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor kanë dakordësuar të rifillojnë, rigjenerojnë dhe rimëkëmbin sektorin e industrisë përmes qasjes së politikave e protokolleve ndër-rajonale"...

Në përgjigje të efektit të pandemisë, qëndrueshmëria e industrisë turistike në Ballkanin Perëndimor si zonë e vetme me shumë-destinacione, normaliteti i ri!

Industria turistike shënon ndikime të forta në ekonomi, politikë, shoqëri e në të tjera fusha ndërsektoriale duke siguruar një pozicion të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Turizmi kontribuon drejtpërdrejt me 15% të GDP të ekonomive të Ballkanit Perëndimor që varion mes shteteve në bazë të cilësisë dhe diversitetit të ofertës turistike, si dhe me rreth 550,000 vende pune në 2019 (OECD, 2019). Ndërsa këto ritme të rritjes rajonale ishin më lartë se mesatarja globale, kufizimet e udhëtimeve të vendosura nga qeveritë për të luftuar përhapjen e pandemisë Covid-19, rezultuan në 98% ulje të vizitorëve ndërkombëtarë në gjysmën e dytë të vitit 2020.

Turizmi konsiderohet sektor strategjik për integrimin ekonomik të Ballkanit Perëndimor dhe duke pasur një varësi të tillë nga industria turistike, ndikimet negative socio-ekonomike të krizës kërkojnë një reagim të ndryshëm dhe përpjekje të përbashkëta për të rivendosur besimin e vizitorëve, për të stimuluar kërkesën për udhëtime dhe për të rimëkëmbur sektorin e turizmit. Nga statistikat, Ballkani Perëndimor vizitohet nga rreth 12 milionë vizitorë në vit nga të cilët 50% janë të huaj.

Rihapja, riaktivizimi e funksionaliteti i gjithë zinxhirit të vlerave të industrisë turistike në "ushtrimin e tij të parë" pas pandemisë, ka mundësinë më të afërt me sezonin turistik të verës 2021. Aktivizimi i plotë me faza duke filluar me turizmin e brendshëm, turizmin ndër-rajonal dhe atë ndërkombëtar kryesisht Evropian për shkak të pozicionimit gjeografik kërkon një sërë masash për t`u adaptuar me konkurrueshmërinë e tregut global, me trendin social të mënyrës se si dhe ku do të udhëtohet më parë si dhe adaptimin e gjithë zinxhirit të vlerës në turizëm me profilin e ri të vizitorit post-pandemik.

Si një përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, angazhimi parësor i ekonomive të Ballkanit Perëndimor është operimi si një hapësirë e vetme turistike me shumë-destinacione, duke koordinuar teknikisht bërjen efektive të rregullave e procedurave administrative të unifikuara për udhëtarët, lehtësimin e vizave e njehsimin e procedurave për turistët në rajon, përmirësime të pikave kufitare dhe adoptimin e teknologjive të reja për udhëtarët, njehsimin e ndërsjellë të kualifikimeve akademike, nisma promocionale të përbashkëta si rajon referuar tregjeve globale

kryesore, protokolle të harmonizuara me protokollet ndërkombëtare për sigurinë, higjenën dhe shëndetin në zonat e strukturat turistike, etj. (Deklarata e Tiranës, Prill 2021 https://www.rcc.int/docs/567/tirana-declaration-on-joint-regional-protocols-to-support-sustainable-tourism-recovery-and-groëth-in-the-ëestern-balkans)

Koordinimi për "të rindërtuar më mirë" industrinë turistike në rajon do të gjenerojë diskutime mes aktorëve publik dhe privat dhe komuniteteve të rajonit për cështje që ata i prekin më shumë në zonat e tyre, përshtatjen me normalitetin e ri të sektorit në termat e aftësimit manaxherial të fuqisë punëtore, cilësisë e përshtatjes së strukturave, infrastrukturës dhe shërbimeve turistike.

Western Balkan 6, the multi-destinations travel bubble - Tirana Declaration (April 08, 2021)

Madlina Puka

Lecturer in Faculty of Social Science, Tourism and Sports – Tourism Department, Ms. Puka discusses how tourism industry is being reorganized in Western Balkan 6 to recover in response to COVID-19 pandemic crisis.
In particular, she talks about the multi-destinations recovery strategic approach for a resilient operation of the tourism industry.

"Because of the COVID-19 pandemic crisis and global travel restrictions, the Western Balkan 6 has 98% reduction of the international visitors in second half of 2020. How promising is the actual summer season?

WB6 economies are now beginning to restart, regenerate and recover the industry sector through intra-regional and whole government policy approach"

The tourism industry records strong influence on the economy, politics, society and other cross-cutting areas, securing an important position in economic development in the Western Balkans region. It significantly contributes to the overall economic development and competitiveness of the region with anticipated spillover effects on trade and investment, human capital development, sustainable valorization of cultural heritage, and small and medium enterprise (SME) growth. It directly contributes 15% to overall GDP of WB economies and the sector accounts for approximately 550.000 jobs in 2019 (OECD, 2019). Whereas these regional growth rates were well above global averages prior to the crisis, the WB economies have been particularly hard hit by Covid-19 pandemic experiencing huge drops in some of them, up to 98% decrease in international visitors in the second half of 2020. As tourism-dependent economies, the negative socio –economic impacts of the crisis required for a different responsiveness and joint efforts to restore traveler confidence, stimulate travel demand and renew the tourism sector. The Western Balkan 6 has been visited around 12 mil visitors (UNWTO, 2019) and half of them are international visitors

Reopening and reactivation of the entire value chain of the tourism industry in its "first exercise" after the pandemic, has the closest opportunity to the summer tourist season 2021. Full operation in phases starting with domestic, inter-regional and international tourism, requires a series of competitive measures and marketing tactics adopted to the global market, in terms of social visitors` trend and adaptation of the entire value chain with the new post-pandemic visitor profile.

In response to the COVID-19 pandemic, the Western Balkan 6 economies are committed to operate as a single multi-destinations' travel bubble, coordinating the effective implementation of unified and mutual rules and administrative procedures for travelers, visa facilitation for visitors of third countries in the region, improvements at border crossings and the adoption of new technologies for travelers, mutual recognition of academic qualifications, implementation of harmonized health and hygiene protocols to align sector recovery efforts and boost traveler confidence; and coordinating promotion and communication to build trust in the WB6 as a responsible, trustworthy and sustainable destination.

(Tirana Declaration on Joint Regional Protocols to Support Sustainable Tourism Recovery and Growth in the Western Balkans, April 2021 https://www.rcc.int/docs/567/tirana-declaration-on-joint-regional-protocols-to-support-sustainable-tourism-recovery-and-growth-in-the-western-balkans

Coordination to "build back better" the tourism industry in the region will generate discussions between public and private actors and communities in the region on issues that affect them most in their areas, adapting to the new normality of the sector in terms of workforce managerial trainings, quality of adaptation of facilities, infrastructure and tourist services.